


REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Nr. 01/2023

**Bordi për Ankesa**, i përbërë nga Ylber Fetahaj – kryetar, Avdyl Hyseni – anëtar dhe Granit Mavriqi - anëtar, lidhur me Kërkesën me Nr. Ref.2308/659/BA/y.f. e datës 15.08.2023 të parashtruesit “Klan Kosova” të paraqitur ndaj Vendimit me Nr. Ref: 2307/590/KPM/j.m., të datës 19.07.2023 të Komisionit të Pavarur të Mediave (KPM), në seancën e mbajtur me datë 18.08.2023, Bordi për Ankesa mori këtë:

### V E N D I M

**HEDHET POSHTË** si e parakohshme Kërkesa Nr. Ref.:2308/659/BA/y.f., e datës 15.08.2023 e parashtruar nga Klan Kosova, lidhur me shtyrjen e ekzekutimit të Vendimit të KPM-së me Nr. 2307/590/KPM/j.m., të datës 19.07.2023.

### A r s y e t i m

Komisioni i Pavarur i Mediave me Vendimin me Nr. 2307/590/KPM/j.m., të datës 19.07.2023, ka refuzuar kërkesën e Klan Kosovës për ndryshimin e pronësisë për bartjen e licencës nga Radio Shqip FM, në emër të biznesit individual Asdren Agushi B.I, në Klan Kosova Sh.P.K.

Kundër këtij Vendimi, më 15.08.2023, Klan Kosova ka paraqitur kërkesë për shtyrjen e ekzekutimit të Vendimit të KPM-së me Nr. 2307/590/KPM/j.m., të datës 19.07.2023.

Bordi për Ankesa, në seancën e mbajtur me datë 18.08.2023, vendosi unanimisht si në dispozitivin e këtij Vendimi për arsyet si në vijim:

- Kërkesa e parashtruar nga Klan Kosova, për mos ekzekutim të Vendimit, është e parakohshme për faktin se Vendimi i KPM-së është i shkallës së parë dhe i njëjti nuk është i ekzekutueshëm që rrjedhimisht nuk prodhon pasoja juridike.
- Çështja kryesore është në procedurë të ankimimit dhe Bordi ende nuk e ka trajtuar çështjen kryesore dhe nuk është marrë ndonjë vendim lidhur me këtë. Vet kërkesa është e

parakohshme për faktin se Ligji i Përgjithshëm i Procedurës Administrative, respektivisht neni 144, përcakton qartë se kur një vendim është i formës së prerë.

Sipas nenit 144 të Ligjit të Përgjithshëm të Procedurës Administrative, përcaktohet që:

*1. Një akt administrativ do të bëhet i ekzekutueshëm me:*

*1.1. skadimin e afatit për ankesën kundër tij, nëse një ankesë e tillë nuk është parashtruar;*

*1.2. njoftimin e palës, me aktin, kur sipas ligjit, nuk lejohet ankesa;*

*1.3. njoftimin e palës me aktin, kur, sipas ligjit, ankesa nuk ka efekt pezullues;*

*1.4. njoftimin e palës me aktin e ndalimit të efektit pezullues të ankesës, në pajtim me paragrafin 3 të nenit 130 të këtij Ligji, apo*

*1.5. njoftimin e palës për refuzimin e ankesës.*

Duke u bazuar në faktin se organi i shkallës së dytë ende nuk ka vendosur për zgjidhjen e ankesës së parashtruar, fakt ky i cili e bën vendimin e organit të shkallës së parë të pa ekzekutueshëm, Bordi për Ankesa bazuar në nenin 144, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5, të Ligjit të lartpërmendur, vendosi që kërkesa për shtyrje të ekzekutimit të vendimit të hedhet poshtë si e parakohshme.

Andaj, Bordi për Ankesa, bazuar në faktet e lartcekura, si dhe bazuar në nenin 44, paragrafi 1, të Ligjit Nr.04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, si dhe nenin 10, paragrafi 2, të Rregullores Nr. BA 2018/01 të Punës së Bordit për Ankesa, vendosi unanimisht si në dispozitivin e këtij vendimi.

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet Padi brenda afatit ligjor prej 30 ditësh nga pranimi i vendimit në Gjykatën Komerciale, Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative.

Vendimi u dërgohet:

-Palëve dhe

-Arkivit të KPM-së.

